



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.181

24 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 191
datë 3.12.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar”..... 8065

Ligj nr.10 192
datë 3.12.2009

Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.... 8069

Ligj nr.10 193
datë 3.12.2009

Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale..... 8080

LIGJ
Nr.10 191, datë 3.12.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT TERRORIZMIT, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6361, datë 22.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT TERRORIZMIT, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Parathënie

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, në vijim të quajtura si “Palët”,

Duke shprehur vullnetin e tyre për të forcuar dhe përmirësuar marrëdhëniet miqësore tashmë ekzistuese dhe bashkëpunuese ndërmjet dy shteteve,

Duke shprehur shqetësimin rreth rrezikut të përhapjes së krimit të organizuar ndërkombëtar, trafikimit ndërkombëtar të paligjshëm të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe prekursorëve, si edhe të terrorizmit,

Duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin ekzistues në të dyja shtetet dhe pa cenuar angazhimet e tyre të mëparshme, bazuar në marrëveshjen dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e treta,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë dhe do të japin asistencë reciproke në fushat e mëposhtme:

- a) lufta kundër terrorizmit;
- b) lufta kundër krimit të organizuar;
- c) lufta kundër kultivimit të paligjshëm, prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
- d) lufta kundër aktiviteteve të paligjshme në lidhje me armët, përfshirë armët biologjike, kimike dhe radiologjike, municionin, lëndët plasëse, materialin bërthamor dhe radioaktiv, si dhe lëndët helmuese;
- e) lufta kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme financiare ndërkombëtare dhe legalizimi i të ardhurave (pastrimi i parave) që rrjedhin nga aktivitetet kriminale;
- f) lufta kundër imigrimit të paligjshëm dhe trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore;
- g) lufta kundër falsifikimit dhe tjetërsimit të çdo lloji dokumenti;
- h) lufta kundër tjetërsimit dhe falsifikimit të kartëmonedhave, si edhe të monedhave, kartave të kreditit, letrave me vlerë dhe dokumenteve të tjera me vlerë;
- i) lufta kundër krimit ndaj personit, shëndetit, lirisë dhe integritetit gjinor;
- j) lufta kundër krimit ndaj pronës dhe veçanërisht vjedhjes dhe trafikimit të paligjshëm të mjeteve;
- k) kërkimi për persona të zhdukur dhe persona që kanë kryer krime brenda territorit të palës tjetër, si edhe identifikimi i kufomave;
- l) lufta kundër trafikimit të paligjshëm të veprave të trashëgimisë historike dhe kulturore, gurëve dhe metaleve të çmuara, si edhe sendeve të tjera me vlerë;
- m) përmirësimi i metodave dhe mjeteve për të ruajtur dhe rikthyer rendin publik dhe menaxhimi i situatave me kriza të tilla, si rrëmbimi i avionëve, rrëmbimi i personave etj.;
- n) lufta kundër krimit kompjuterik;
- o) bashkëpunimi në fusha kulturore, sportive dhe sociale nëpërmjet shkëmbimit të delegacioneve policore;
- p) mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Palët do të bashkëpunojnë edhe në fusha të tjera që kanë të bëjnë me kriminalitetin në përgjithësi, parandalimin e krimit dhe ruajtjen e rendit publik nëse ekziston interesi reciprok.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërmjet dy palëve në fushat e përmendura më lart në nenin 1 do të arrihet nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës në fusha me interes të përbashkët;
- b) shkëmbimit të eksperiencës mbi përdorimin e teknologjisë së policisë shkencore, si dhe mbi metodat dhe mjetet e kërkimit kriminologjik;
- c) shkëmbimit të informacionit, njohurive dhe eksperiencës në fushën e kontrollit të kufijve, si dhe mbështetja materiale dhe teknike për shërbimet e kontrollit të pasaportave, me qëllim zbulimin e dokumenteve të falsifikuara dhe të tjetërsuara dhe për të parandaluar hyrjen e paligjshme dhe migracionin e paligjshëm.
- d) shkëmbimit të mostrave të dokumenteve të reja të udhëtimit, vulave dhe llojeve të vizave, në mënyrë që të parandalohet dhe t'i jepet fund kalimit të paligjshëm të kufijve;
- e) shkëmbimit të informacionit për parandalimin dhe shtypjen e çdo forme krimi, në veçanti të të gjitha akteve të terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm të armëve dhe të materialeve radioaktive;
- f) shkëmbimit të informacionit, eksperiencës, njohurive të specializuara dhe asistencës mbi metodat e reja të përdorura për prodhimin e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, trafikimin ndërkombëtar të tyre, fshehjen dhe shpërndarjen e tyre, si dhe mbi metodat e reja për t'i luftuar ato, në përputhje me Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike të vitit 1961, e ndryshuar me Protokollin e Amendimit të vitit 1972, Konventën mbi lëndët psikotrope të vitit 1971 dhe Konventën e Kombeve

të Bashkuara të vitit 1988 kundër trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope;

g) shkëmbimit të legjislacionit përsa i përket specifikimeve në këtë marrëveshje;

h) shkëmbimit të publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

i) trajnimit dhe formimit profesional të oficerëve të policisë.

Neni 3

Në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i bashkëpunimit, palët do të mbajnë takime me ekspertë brenda kufirit të kësaj Marrëveshjeje, sa herë që të dyja palët bien dakord që kjo është nevojshme.

Neni 4

1. Secila palë mund të dërgojë një ose më tepër oficerë ndërlidhës, pranë misionit të tij diplomatik apo autoritetit konsullor në territorin e palës tjetër, për një periudhë kohe të caktuar ose të papërcaktuar.

2. Oficerëve ndërlidhës do t'u jepen kompetenca informative dhe konsultuese. Në mënyrë të veçantë, detyrat e tyre do të përfshijnë:

a) Nxitjen e shkëmbimit të informacionit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër veprave penale.

b) Dhënien e ndihmës, lidhur me aktivitetet e autoriteteve kompetente për mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm të shteteve të tyre.

3. Oficerët ndërlidhës nuk do të kenë detyra operacionale.

Neni 5

1. Secila palë mund ta refuzojë tërësisht apo pjesërisht bashkëpunimin në raste të tilla, kur mund të vihet në rrezik sovraniteti i saj kombëtar, siguria e saj ose interesat e saj kombëtarë ose kur ajo është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar.

Refuzimi i bashkëpunimit do t'i shprehet me shkrim palës tjetër pa vonesë.

2. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të secilës palë.

3. Asnjë nga palët nuk do të bëjë publike apo të transferojë tek një vend i tretë asnjë informacion konfidencial, me përjashtim kur për këtë merret pëlqimi i palës tjetër.

4. Shërbimet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës:

Spektori për bashkëpunim ndërkombëtar në Ministrinë e Sigurisë

Për bashkëpunim të drejtpërdrejtë në raste shumë urgjente, palët do të shkëmbejnë një listë që përmban shërbimet e autorizuar përgjegjëse për komunikim dhe bashkëpunim.

Neni 6

1. Palët do të krijojnë një komitet koordinimi, përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, i cili do të kryesohet nga Ministri i Brendshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministri i Sigurisë për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës ose nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy ministrive, me pjesëmarrjen e ekspertëve. Komiteti i Koordinimit do të sigurojë gjithashtu nxitjen dhe vlerësimin e kësaj Marrëveshjeje.

Përfaqësues të ministrive të tjera ose të autoriteteve qeveritare mund të marrin pjesë në takimet e këtij komiteti, nëse është e nevojshme.

2. Komiteti i Koordinimit do të mbledhet në periudha të përcaktuara në bazë konsultimesh, në mënyrë të alternuar, në Republikën e Shqipërisë dhe në Bosnjë-Hercegovinë.

3. Gjuha angleze do të jetë gjuha me të cilën do të punohet, duke mos përjashtuar përdorimin e ndonjë gjuhe tjetër që flitet shumë.

Neni 7

Palët angazhohen të zbatojnë të gjitha dispozitat përkatëse që përfshihen në ligjet e tyre për mbrojtjen e të dhënave, gjatë shkëmbimit të çdo lloji të dhënash personale për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që vendosin detyrime për palët.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet të cilit secila palë informon tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth përmbushjes së procedurave të saj të brendshme përkatëse.

2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e një njoftimi me shkrim që i komunikohet tridhjetë ditë më parë palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Secila palë, në çdo kohë, mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit pulik dhe shëndetit publik. Pezullimi, ashtu sikurse dhe tërheqja e palës nga Marrëveshja do t'i komunikohet palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Si pezullimi ashtu dhe tërheqja e palës do të hyjnë në fuqi një ditë pas marrjes së njoftimit përkatës.

Neni 10

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet miratimit të ndërsjellë ndërmjet palëve. Të gjitha ndryshimet dhe shtesat duhet të paraqiten me shkrim. Palët do të hyjnë në konsultime në lidhje me ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje, me kërkesën e secilës prej palëve me qëllim arritjen e një pëlqimi të përbashkët të palëve. Çdo ndryshin do të hyjë në fuqi sipas procedurës së përshkruar në paragrafin 1 të nenit 9.

Bërë në Sarajevë, më 24 mars 2009, në dy kopje origjinale, në shqip, në gjuhët zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate, serbe) dhe anglisht.

LIGJ
Nr. 10 192, datë 3.12.2009

PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMIT
NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

c) kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal;

ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.

d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrra, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtira, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni;

b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

4. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

Neni 4

Masa parandaluese

Në kuptim të këtij ligji, “Masë parandaluese” është çdo masë me karakter pasuror, që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre.

Neni 5

Marrëdhënia me procedimin penal

1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Neni 6

Objekt i verifikimeve

1. Ndaj personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji kryhen verifikime për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik, si dhe për burimet e të ardhurave të tyre.

2. Verifikimet bëhen, në veçanti, nëse këta persona janë zotërues të lejeve, licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale, si dhe për të verifikuar nëse ata përfitojnë kontribute, financime ose kreditime të çdo lloji, të dhëna apo të përfituara nga shteti, ente a persona juridikë publikë, organizma ose institucione ndërkombëtare, si dhe për të verifikuar nëse pasuritë, veprimtaritë apo të drejtat pasurore janë të përligjura.

Neni 7

Kompetenca dhe përbërja e gjykatës

1. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykata e shkallës së parë të krimeve të rënda dhe në shkallë të dytë, nga gjykata e apelit të krimeve të rënda.

2. Gjkata e shkallës së parë të krimeve të rënda gjykon kërkesat për sekuestrimin e pasurive me një gjyqtar të vetëm. Kërkesat për konfiskimin e pasurive gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

3. Gjkata e apelit për krimet e rënda gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

4. Për njoftimet, afatet dhe procedurën e gjykimit zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, rregullat e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 8
Verifikimet paraprake

1. Prokuroria dhe policia gjyqësore marrin dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, me iniciativën e vet ose me njoftim të bërë nga të tretët.

2. Me marrjen dijeni për pasuritë, që duhen verifikuar, sipas këtij ligji, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur.

3. Prokurori kryen veprime vetë dhe nëpërmjet Policisë Gjyqësore për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale, mënyrës së jetesës, si dhe të burimeve të të ardhurave të personave, subjekte të zbatimit të këtij ligji.

Neni 9
Detyrimi i dorëzimit të informacionit dhe të dokumenteve

1. Prokurori, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Policisë Gjyqësore, mund të kërkojë pranë çdo zyre të administratës shtetërore, enti a personi juridik publik, personave të tjerë fizikë dhe juridikë, të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që vlerësohen si të domosdoshme për qëllime verifikimi ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

2. Me autorizim të lëshuar nga prokurori ose gjykata, oficerët e Policisë Gjyqësore mund të vendosin sekuestrimin e dokumenteve të shqyrtuara, sipas rregullave të parashikuara në nenet 208, 209, 210 dhe 211 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 10
Kryerja e veprimeve të posaçme

1. Gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, mund të kryejë veprime të tjera të posaçme, që nuk rregullohen shprehimisht me ligj, nëse ato vlejnë për zgjidhjen e çështjes dhe nuk prekin thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

2. Nëse gjatë gjykimit lind nevoja për ndihmë juridike ndërkombëtare, zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuara nga shteti shqiptar, si dhe dispozitat respektive procedurale.

KREU II
SEKUESTRIMI I PASURISË

Neni 11
Kriteret për sekuestrim të pasurisë

1. Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie që tregojnë se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Procedura e sekuestrimit

1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata, me pjesëmarrjen e prokurorit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij.

2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.

3. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha tremujore, por jo më shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit të masës së sekuestrimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në një gjykatë të një niveli më të lartë.

4. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurive të paluajtshme ose pasurive të regjistruara në regjistra publikë, administratori i emëruar bën menjëherë njoftimin e kësaj mase në zyrat, pranë të cilave mbahen këta regjistra.

5. Prokurori, jo më vonë se 5 ditë përpara mbarimit të afatit kohor të masës së sekuestrimit, të parashikuar në pikën 2 ose 3 të këtij neni, mund të paraqesë kërkesë për konfiskimin, e pasurisë ose zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit. Në rast të kërkesës për konfiskim, masa e sekuestrimit vazhdon deri në përfundimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë.

6. Mosparaqitja e kërkesës, sipas pikës 5 të këtij neni, passjell shuarjen e masës së sekuestrimit. Megjithatë, shuarja e sekuestrimit nuk pengon paraqitjen dhe pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë.

Neni 13
Vendimet e gjykatës kur revokohet masa e sekuestrimit

1. Me vendimin e revokimit të masës së sekuestrimit, gjykata mund të vendosë detyrimin ndaj pronarit të pasurisë apo personit që ka në përdorim ose administrim pasurinë, apo pjesë të saj, për të njoftuar, për një periudhë jo më pak se 5 vjet, në Policinë Tatimore, akte të zotërimit, blerjes ose pagesave të kryera, të pagesave të marra, detyrave profesionale, të administrimit ose kujdestarisë, si dhe akte apo kontrata të tjera, sipas llojit dhe vlerës së përcaktuar nga gjykata, në varësi të pasurisë dhe të të ardhurave të personit, por jo për një vlerë më të vogël se 2 milionë lekë.

2. Njoftimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni bëhen brenda 10 ditëve nga përfundimi i aktit dhe, në çdo rast, brenda datës 31 janar të çdo viti, për aktet e kryera në vitin pararendës.

3. Personit që nuk respekton detyrimet e njoftimit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, i konfiskohen, tërësisht ose pjesërisht, sendet e fituara dhe pagesat e marra, për të cilat nuk është respektuar detyrimi i njoftimit.

Neni 14
Ekzekutimi i masës së sekuestrimit

1. Për ekzekutimin e masës së sekuestrimit, sipas këtij ligji, zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullat e Kodit të Procedurës Civile, nëse ky ligj nuk parashikon ndryshe.

2. Vendimi për marrjen e masës së sekuestrimit të pasurisë dhe vendimi për zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit i njoftohen nga gjykata zotëruesit të pasurisë së sekuestruar, sipas neneve 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Përmbaruesi gjyqësor inventarizon sendet e sekuestruara në prani të administratorit të pasurisë, të caktuar për administrimin e kësaj pasurie dhe të personit zotërues të pasurisë, mbi të cilën është marrë masa e sekuestrimit, nëse ai e kërkon një gjë të tillë. Përmbaruesi gjyqësor dokumenton inventarizimin dhe dorëzimin e pasurive tek administratori me procesverbal, i cili nënshkruhet nga të pranishmit.

4. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton rregullat dhe procedurat e hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit.

KREU III

ADMINISTRIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 15

Administratori i pasurisë së sekuestruar

1. Gjykata, në vendimin e sekuestrimit të pasurisë, cakton, gjithashtu, nga lista e ekspertëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara një a më shumë administratorë. Agjencia vë në dispozicion të gjykatës lisën e administratorëve, me persona të punësuar ose të autorizuar prej saj, të paktën një herë në vit dhe tregon kriteret e caktimit të tyre.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me kërkesë të administratorit, mund ta autorizojë atë të kërkojë ndihmën e specialistëve ose të personave të tjerë, të cilët shpërblehen për punën e bërë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Detyrat e administratorit

1. Administratori ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive.

2. Administratori, i caktuar me vendim gjykate për ekzekutimin e masës së sekuestrimit dhe për administrimin e sendit, paraqet çdo kërkesë të nevojshme pranë prokurorisë, shërbimit përmbarimor apo çdo institucioni tjetër shtetëror.

3. Gjykata, edhe kryesisht, mund ta shkarkojë administratorin nga detyra, në çdo kohë, për paaftësi ose për mospërbushje të detyrës. Kërkesa në gjykatë paraqitet nga prokurori kryesisht ose me propozim të motivuar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Neni 17

Ndalime për administratorin

Përveç rasteve kur autorizohet paraprakisht nga gjykata, administratori nuk lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurisë së sekuestruar, apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshme.

Neni 18

Raportimet e administratorit

1. Brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, administratori detyrohet t'i paraqesë gjykatës një raport të hollësishëm për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes, në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar. Në vijim, sipas afateve të caktuara nga gjykata, administratori i paraqet asaj raporte periodike për administrimin e pasurisë së sekuestruar, të shoqëruara, nëse kërkohet, me dokumentacionin përkatës.

2. Administratori është i detyruar të njoftojë gjykatën edhe për pasuri të tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit.

3. Administratori detyrohet që raportet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni t'ia dërgojë njëkohësisht prokurorit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Neni 19

Kalimi i të drejtave reale për pasuritë e sekuestruara

Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, për pasuritë, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, mund të vendosë kalimin e të drejtave reale tek të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. Të drejtat reale nuk kalohen te personat e parashikuar në nenin 3 pika 2 të këtij ligji.

Neni 20

Përballimi i shpenzimeve të administrimit

1. Shpenzimet e nevojshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruara nga administratori, në çdo lloj cilësie a burimi të ligjshëm.

2. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, ato parapaguhën nga shteti nëpërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Në rastet e vendosjes së masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori ose Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre. Nëse fondet e llogarive të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhën pjesërisht ose plotësisht nga shteti, pa të drejtë kompensimi.

4. Kur gjykata vendos revokimin e masës së sekuestrimit, zotëruesi i pasurisë ka të drejtë të kërkojë frutat e pasurisë, të realizuara gjatë administrimit. Ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin në masën e pakësimit të vlerës së pasurisë ose të dëmit që i është shkaktuar pasurisë.

KREU IV

KONFISKIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR

Neni 21

Kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës

1. Masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa.

2. Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit.

3. Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.

Neni 22

Procedura gjyqësore e konfiskimit

1. Gjatë gjykimit të kërkesës për konfiskim zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kodit të procedurës Civile.

2. Me kërkesë të prokurorit gjykata mund të vazhdojë gjykimin edhe në raste kur personi nuk ka banim të njohur brenda vendit, është larguar jashtë vendit ose, me gjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet. Në këtë rast gjykata vendos mosgjetjen e personit, duke i caktuar atij një avokat. Avokati mund të caktohet kryesisht nga gjykata ose të zgjidhet nga të afërmit e personit.

3. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del se pasuritë e sekuestruara u përkasin personave të tretë, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të arsyetuar, i thërret ata për të ndërhyrë në proces.

4. Personi i tretë, brenda afatit që i caktohet nga gjykata, ka të drejtë të paraqesë në seancë pretendimet e veta, si dhe të kërkojë marrjen e të dhënave të tjera të nevojshme.

5. Kur vërtetohet se disa pasuri i janë transferuar apo janë regjistruar në emër të të tretëve, me veprime juridike fiktive ose të simuluar, gjykata konstaton pavlefshmërinë e këtyre veprimeve juridike. Për këtë qëllim, kur nuk provohet e kundërta, prezumohen fiktive ose të simuluar edhe:

a) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull barrësor, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese kundër personave të afërm;

b) transferimet dhe regjistrimet në emër të të tretëve dhe me titull falas apo dukshëm nën vlerën e tregut, të kryera brenda dy viteve përpara paraqitjes së kërkesës për marrjen e masës parandaluese.

Neni 23

Kohëzgjatja e gjykimit të kërkesës për konfiskim

1. Gjykata, brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit, sipas nenit 21 të këtij ligji, vendos mbi kërkesën për konfiskimin e pasurisë.

2. Në raste komplekse, gjykata, edhe kryesisht, mund të japë vendimin e saj në një afat të mëvonshëm, por gjithsesi brenda një viti nga data e paraqitjes së kërkesës për konfiskim.

Neni 24

Pranimi i kërkesës për konfiskim

1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.

2. Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak:

i) të pamjaftueshmërisë së provave;

ii) të vdekjes së personit;

iii) se personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;

b) personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak:

i) të pamjaftueshmërisë së provave;

ii) se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet;

c) personi është proceduar për një vepër penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.

Neni 25

Shpenzimet procedurale

1. Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e sekuestrimit, të administrimit, të konfiskimit, të avokatit, si dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar rregullisht.

2. Shpenzimet për sekuestrimin, sipas këtij ligji, parapaguhet nga shteti dhe paguhet nga personi, ndaj pasurive të të cilit vendoset sekuestrimi i pasurisë.

3. Gjykata, në vendimin përfundimtar të kërkesës për konfiskim, cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti.

4. Shpenzimet e parapaguara nga shteti nuk paguhet, sipas pikës 2 të këtij neni, nëse gjykata nuk vendos masën e konfiskimit të pasurisë.

5. Për ankesat për shpenzimet procedurale vendos gjykata që ka dhënë vendimin.

KREU V
VENDIMI, ANKIMI DHE EKZEKUTIMI I MASAVE PARANDALUESE

Neni 26
Elementet e vendimit të gjykatës

Vendimi i gjykatës për marrjen e masës parandaluese, veç elementeve të parashikuara në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban edhe:

- a) llojin e masës parandaluese dhe kohëzgjatjen e saj, nëse masa është caktuar me afat;
- b) llojin e pasurisë me të gjitha të dhënat, që shërbejnë për identifikimin e saj, përfshirë edhe vendndodhjen, ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë;
- c) parashtrimin e përmbledhur të faktit dhe shkakun ligjor të masës parandaluese;
- ç) masën e shpenzimeve procedurale, llojin e tyre, si dhe të dhëna për personin, të cilit i ngarkohen ato.

Neni 27
Ankimi

1. Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo të shuarjes së masës së sekuestrimit, mund të bëhet ankimi në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë mund të bëhet ankimi në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve, të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

3. Ankimi, sipas pikës 1 ose 2 të këtij neni, nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 28
Ekzekutimi i vendimit të konfiskimit dhe revokimit të sekuestrimit

1. Vendimi i konfiskimit të pasurive vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij.

2. Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.

3. Gjatë ekzekutimit të vendimit të konfiskimit, gjykata, që ka dhënë vendimin, mund të nxjerrë, në dhomë këshillimi, urdhra për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, ku përcakton edhe afatet e mënyrat e kryerjes së veprimeve dhe masat e nevojshme që duhen marrë.

4. Procedura e ekzekutimit të vendimit të pranimit të kërkesës për konfiskim përjashtohet nga pagesa paraprake e tarifës së shërbimit. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat dhe procedurat e hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbartimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5. Vendimi dhe urdhrat e posaçëm zbatohen nga përmbartuesi gjyqësor, i caktuar nga gjykata. Organi drejtues i shërbimit përmbartimor vë në dispozicion të gjykatës lisën e përmbartuesve gjyqësorë të paktën një herë në vit dhe tregon kriteret e caktimit të tyre.

6. Përmbartuesi gjyqësor raporton kryesisht ose me kërkesë të gjykatës për ekzekutimin e vendimit dhe të urdhrave të posaçëm.

KREU VI
PËRDORIMI I PASURIVE TË KONFISKUARA

Neni 29
Kalimi i pasurive të konfiskuara në pronësi të shtetit

1. Pasuritë e konfiskuara me vendim gjykate, sipas këtij ligji, kalojnë në pronësi të shtetit.

2. Vendimi i formës së prerë për konfiskimin e pasurive i dërgohet menjëherë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Kur vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme. Në këtë rast, zotëruesi i tyre ka të drejtë të kërkojë zhdëmtimin e drejtë, nëse në vijim provohet paligjshmëria apo pabazueshmëria e konfiskimit.

Neni 30

Kompetenca për mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara

1. Ministri i Financave, bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe në raportin e vlerësimit tekniko-financiar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vendos mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara, sipas këtij ligji, në përputhje me kriteret e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, brenda 90 ditëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 29 të këtij ligji, i paraqet Ministrin të Financave raportin e vlerësimit tekniko-financiar për çdo pasuri të konfiskuar.

3. Ministri i Financave, me urdhër, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit të pasurive të paluajtshme të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor të parashikuar në pikën 2 të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 31

Detyrat e administratorit të pasurive të konfiskuara

Administratori i caktuar nga gjykata, gjatë fazës së sekuestrimit të pasurive, vazhdon ushtrimin e detyrave, në emër dhe për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për aq kohë sa nuk është zëvendësuar prej saj me një person tjetër.

Neni 32

Përdorimi i pasurive të luajtshme dhe i mjeteve monetare

Administratori kryen veprimet e nevojshme për të dorëzuar në llogaritë e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara fondet në mjete monetare:

a) të konfiskuara, që nuk do të përdoren për administrimin e pasurive të tjera të konfiskuara, ose që nuk do të përdoren për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale të krimit të organizuar;

b) të përfituara nga shitja e pasurive të luajtshme, që nuk përdoren në veprimtarinë e personit juridik tregtar dhe të titujve, në vlerën neto, të përfituara nga shitja e pasurive për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar. Nëse procedurat e shitjes nuk janë ekonomike, Ministri i Financave vendos transferimin e pronësisë pa pagesë ose shkatërrimin e pasurisë së konfiskuar nga administratori;

c) që përfitohen nga rimarrja e kredive personale, nëse procedura e rimarrjes së tyre nuk është ekonomike ose, kur pas verifikimeve të bëra nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për aftësinë paguese të debitorit. Nëse rezulton se ai nuk ka aftësi paguese, kreditë personale anulohen nga Ministri i Financave.

Neni 33

Përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe i atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrin të Financave, përcakton kriteret, masën dhe mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe të atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, pjesë e fondit të posaçëm, brenda kufijve të destinimit, të vendosura nga ky ligj.

2. Këshilli i Ministrave, në nxjerrjen e këtij vendimi, bazohet në parimet e miradministrimit të pronës, të rritjes së efektivitetit të drejtësisë penale, si dhe të rehabilitimit dhe zhdëmtimit të drejtë.

Neni 34

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

2. Rregullat e hollësishme për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara caktohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Rregullat e hollësishme për kriteret e vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 35

Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar

1. Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e pasurive të konfiskuara ngrihet dhe funksionon Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar. Ky komitet mblidhet pranë Ministrisë së Financave.

2. Komiteti përbëhet nga tetë anëtarë, të propozuar respektivisht nga Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, ministri që mbulon çështjet e rendit publik, ministri që mbulon çështjet sociale, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Kryetari i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë. Anëtar i propozuar nga Ministri i Financave është kryetar i komitetit.

3. Në veprimtaritë e komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike ose organizatave të tjera, vendase a të huaja, veprimtarë në fusha me interes për zbatimin e këtij ligji.

4. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara i raporton, të paktën një herë në tre muaj, komitetit për veprimtarinë e saj.

5. Komiteti, bazuar në prioritetet e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji, jep rekomandime që i drejtohen Ministrisë së Financave për disponimin efektiv të të ardhurave brenda Buxhetit të Shtetit, përfshirë edhe rekomandimin për pagimin e shpenzimeve operative të agjencisë.

6. Komiteti, të paktën një herë në gjashtë muaj, u kërkon informacion me shkrim institucioneve qendrore, që i kanë në administrim, si dhe të dhëna të hollësishme për gjendjen dhe mënyrën e përdorimit të pasurisë së paluajtshme njësisë vendore, që i kanë në pronësi pasuritë e paluajtshme të konfiskuara.

7. Komiteti mblidhet, së paku, një herë në 3 muaj. Komiteti miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të tij.

Neni 36

Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave

Ministri i Financave, në përfundim të çdo viti financiar, i paraqet Këshillit të Ministrave raportin për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, sipas këtij ligji.

Neni 37

Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit

1. Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji, për vitet financiare 2009-2010, në masën 50 për qind, do të shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Pas kalimit të këtij afati, fondi i posaçëm dhe masa e tij përcaktohen në legjislacionin buxhetor.

2. Ky fond shërben për:

a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë;

b) përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;

c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale.

3. Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit mund të jenë:

a) njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;

b) organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që, në tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës, zhvillojnë veprimtari të tilla.

4. Kërkesat për financimin e projekteve, sipas këtij neni, verifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit për mendim në Komitetin Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre bëhen nga struktura e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

5. Ministri i Financave, mbështetur në rekomandimin e Komitetit Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, me urdhër, përcakton financimin e projektit dhe mënyrat e përdorimit të fondit të vënë në dispozicion të kërkuarit.

6. Pjesa e fondit, e destinuar sipas pikës 2 të këtij neni, nuk mund të përdoret për shpërblime të funksionarëve të institucioneve përfituese.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38

Dispozitë kalimtare

Kërkesat për marrjen e masave parandaluese, të paraqitura nga prokurori në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të gjykojnë, sipas rregullave të këtij ligji.

Neni 39

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 15 pika 2, 28 pika 4, 33 dhe 34 të këtij ligji.

Neni 40

Shfuqizime

Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6362, datë 22.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 193, datë 3.12.2009

**PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET
PENALE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 2

Përkufizime

Për efekte të zbatimit të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritete gjyqësore të huaja” janë autoritetet e huaja, që, sipas ligjit të huaj përkatës, u është dhënë cilësia për të kërkuar, dhënë ose përcjellë kërkesa që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

2. “Autoritete gjyqësore vendase” janë autoritetet e përcaktuara nga ligji nr. 8498, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”.

3. “Letërkërkesë” është forma me të cilën paraqiten kërkesat që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

4. “Ministria e Drejtësisë” është Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.

5. “Shtetas i huaj” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

6. “Shtet dënues” është shteti, në të cilin është dënuar një person.

7. “Shtet i kërkuar” është shteti, të cilit i drejtohet një letërkërkesë.

8. “Shtet kërkuar” është shteti, autoriteti kompetent gjyqësor i të cilit paraqet kërkesa që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen:

a) në procedimet që lidhen me veprat penale, të cilat, në çastin e paraqitjes së kërkesës, janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkuar ose në Republikën e Shqipërisë;

b) në procedimet që janë në juridiksionin e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 4
Llojet e letërkërkesave

Kërkesat që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare në përputhje me këtë ligj janë:

a) “Letërporositë”, ku përfshihen njoftimet e akteve, si dhe marrja e akteve të tjera dhe provave të procedimit penal.

b) Kërkesat e tjera, ku përfshihen ekstradimi i personave të proceduar penalisht, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të huaja, transferimi i procedimeve penale dhe transferimi i personave të dënuar.

Neni 5
Rregullat e përgjithshme mbi letërkërkesën

1. Letërkërkesa e autoriteteve gjyqësore vendase paraqitet me shkrim dhe, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe, duhet të përmbajë:

a) autoritetin që ka kërkuar letërkërkesën, emrin e shtetit të kërkuar dhe, kur është e mundur, emrin e autoritetit, të cilit i drejtohet letërkërkesa;

b) një përcaktim të saktë të llojit të kërkesës që krijon marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare, arsyet e dërgimit të letërkërkesës dhe bazën ligjore;

c) një përshkrim të procedimit penal që është duke u zhvilluar;

ç) një përshkrim të faktit penal, duke treguar kohën dhe vendin e tij, emërtimin ligjor të veprës penale, si dhe kopje të tekstit të dispozitave ligjore të brendshme të zbatuara;

d) gjenealogjetet, duke përmendur shtetësinë e personit që ka lidhje me objektin e letërkërkesës, si edhe pozitën e tij në procedimin penal;

dh) aktet që i bashkëngjiten letërkërkesës, nëse ka, të evidentuara edhe në një listë;

e) deklarin, nëse çështja është urgjente dhe afatin brenda të cilit nevojitet ekzekutimi, së bashku me arsyet e urgjencës apo afatit;

ë) çdo informacion tjetër, që mund të jetë me rëndësi për procedurën e ekzekutimit të letërkërkesës.

2. Letërkërkesa e autoriteteve gjyqësore të huaja dhe dokumentet bashkëlidhur, në rast se nuk shoqërohen me një kopje në gjuhën shqipe, përkthehen nga Ministria e Drejtësisë.

3. Letërkërkesa paraqitet nga autoritetet gjyqësore vendase e nënshkruar dhe e vulosur, si dhe e shoqëruar me përkthim në gjuhën e vendit të cilit i drejtohet letërkërkesa. Kur shteti i huaj ka përcaktuar se pranon letërkërkesat në një gjuhë tjetër, autoriteti gjyqësor vendas mund ta paraqesë kërkesën në gjuhën e pranuar. Në rast urgjence apo gjuhe jo shumë të njohur, përkthimi kryhet nga Ministria e Drejtësisë, me kërkesë të motivuar nga autoriteti gjyqësor vendas. Shpenzimet e përkthimit evidentohen dhe i përcillen autoritetit gjyqësor vendas për t’u përfshirë në shpenzimet procedurale të parapaguara, sipas nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale. Rregulla më të detajuara për formën e letërkërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Autoriteti gjyqësor vendas, nëse e çmon të nevojshme, mund të bëjë shtesa të letërkërkesës, në përputhje me kushtet e këtij neni.

5. Letërkërkesa dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar, korrierit diplomatik. Ajo mund të dorëzohet edhe nëpërmjet mjeteve të tjera teknike të përshtatshme, por me kusht që të konfirmohet marrja në dorëzim.

6. Autoritetet gjyqësore vendase i ekzekutojnë letërkërkesat pa vonesë.

Neni 6
Autoriteti qendror

1. Letërkërkesa e autoriteteve gjyqësore vendase i përcillet autoriteteve gjyqësore të huaja nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, përveç rastit kur ky ligj parashikon ndryshe. Në rast se Ministria

e Drejtësisë konstaton se letërkërkesa nuk plotëson kushtet e nenit 5 të këtij ligji, ia kthen autoritetit gjyqësor vendas për plotësimin e të metave.

2. Në rast urgjence, autoritetet gjyqësore vendase mund t'i përcjellin letërkërkesat drejtpërdrejt, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm parashikon ndryshe. Në rast të përcjelljes së drejtpërdrejtë të letërkërkesave, autoriteti gjyqësor vendas njofton njëkohësisht Ministrinë e Drejtësisë.

3. Letërkërkesat e autoriteteve gjyqësore të huaja i përcillen autoriteteve gjyqësore vendase nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm parashikon ndryshe.

Neni 7

Përcjellja e letërkërkesës tek autoriteti kompetent

1. Ministria e Drejtësisë i jep rrugë letërkërkesës së huaj pasi vlerëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm. Në vijim, letërkërkesa i përcillet prokurorit të rrethit ku duhet ekzekutuar letërkërkesa, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Nëse autoriteti gjyqësor vendas ka kompetencë për ekzekutimin e një prej disa veprimeve të kërkuara, atëherë ai mund të procedojë me ekzekutimin e të gjitha veprimeve, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme.

3. Kur autoriteti gjyqësor vendas, që merr një letërkërkesë, nuk ka kompetencë për ekzekutimin e saj, ai ia përcjell kërkesën pa vonesë autoritetit gjyqësor vendas kompetent dhe njofton njëkohësisht Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 8

Refuzimi i letërkërkesës

1. Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti gjyqësor vendas i japin rrugë letërkërkesës kur plotësohen kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm.

2. Këto autoritete mund të refuzojnë letërkërkesat e parashikuara në nenin 4 pika 2 të këtij ligji, edhe për shkaqe të tjera të parashikuara në ligj.

3. Në rast të veprave penale kundër njerëzimit apo vlerave të tjera të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, tentativave për t'i kryer ato, si dhe bashkëpunimit në kryerjen e tyre, Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti gjyqësor vendas nuk mund të refuzojnë letërkërkesën me shkakun se përbëjnë vepra penale politike.

4. Vendimi i refuzimit të një letërkërkesë përmban arsyet e refuzimit dhe bazën ligjore.

Neni 9

Reciprociteti

1. Letërkërkesa e autoritetit gjyqësor të huaj pranohet nëse përmban garancitë për reciprocitet, të dhëna nga shteti kërkuar, që përfshijnë pritshmërinë që ky shtet të ekzekutojë një kërkesë të ngjashme të drejtuar nga autoritetet gjyqësore vendase.

2. Ministria e Drejtësisë, pavarësisht pikës 1 të këtij neni, mund t'i japë rrugë letërporosive edhe në mungesë të garancive të shprehura për reciprocitet.

Neni 10

Njoftimet

1. Me kërkesë të autoritetit gjyqësor të huaj, autoriteti gjyqësor vendas që procedon, njofton fillimin e ekzekutimit të letërkërkesës, me përjashtim të rastit kur ekzekutimi është i menjëhershëm.

2. Nëse letërkërkesa nuk plotësohet brenda afatit të kërkuar në letërkërkesë dhe kjo ka pasoja në procedimin që zhvillon autoriteti gjyqësor i huaj, autoriteti gjyqësor vendas që procedon, njofton menjëherë autoritetin gjyqësor të huaj se kur është e mundur të ekzekutohet letërkërkesa.

3. Njoftimet, sipas këtij neni, i përcillen autoritetit gjyqësor të huaj nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 11

Plotësimi i letërkërkesave dhe pengesat për ekzekutimin e tyre

1. Nëse letërkërkesa e huaj nuk përmban informacionin e nevojshëm për ekzekutimin e saj, Ministria e Drejtësisë njofton autoritetin gjyqësor të huaj ta plotësojë, pa ia përcjellë atë organit të prokurorisë. Përcjellja e letërkërkesës bëhet nga Ministria e Drejtësisë pas plotësimit të saj nga autoriteti gjyqësor i huaj.

2. Nëse letërkërkesa mund të ekzekutohet pjesërisht ose e kushtëzuar, Ministria e Drejtësisë, edhe kryesisht, e njofton shtetin kërkues dhe i jep mundësinë për të dhënë mendimin e tij ose për të plotësuar kërkesën.

3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni mund të paraqiten edhe nga autoriteti gjyqësor vendas që procedon, nëse me marrjen e akteve e çmon një gjë të tillë. Këto kërkesa i paraqiten drejtpërdrejt autoritetit të shtetit kërkues, duke njoftuar në të njëjtën kohë Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 12

Konfidencialiteti

1. Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti kompetent gjyqësor vendas, me kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, zbatojnë rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionin e treguar në letërkërkesë.

2. Nëse kërkesa e referuar në pikën 1 të këtij neni nuk mund të plotësohet, Ministria e Drejtësisë ose autoriteti gjyqësor vendas njoftojnë brenda 5 ditëve autoritetin gjyqësor të huaj.

KREU II

LETËRPOROSITË

Neni 13

Llojet e letërporsive dhe fusha e zbatimit

1. Llojet e letërporsive janë:

a) njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal;

b) njoftimi i urdhrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues;

c) masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal;

ç) pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive;

d) transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre;

dh) veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji.

2. Krahas rasteve të procedimeve penale të parashikuara nga neni 3 i këtij ligji, ekzekutohen letërporsitë e autoriteteve gjyqësore të huaja në procedimet administrative, nëse vendimi i dhënë në përfundim të tyre mund të ankimohet në një gjykatë me juridiksion penal. Ky rregull zbatohet deri në masën që parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Veprimet për ekzekutimin e letërporsive

1. Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporsia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e

akteve. Në raste urgjente, Ministria e Drejtësisë mund t'ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm.

2. Prokurori i rrethit paraqet kërkesën në gjykatë për të disponuar ekzekutimin e letërporosisë me vendim, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Ky rregull nuk zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 15

Përcjellja e drejtpërdrejtë e letërporosive

1. Krahas mënyrave të përcjelljes së letërkërkesave të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji dhe vetëm për qëllime të këtij kreu, letërporositë mund të përcillen edhe drejtpërdrejt nëpërmjet autoriteteve gjyqësore vendase dhe të huaja, në raste urgjente.

2. Në këtë rast, autoriteti gjyqësor vendas i dërgon njëkohësisht Ministrisë së Drejtësisë kopje të këtyre letërporosive.

3. Ky nen nuk zbatohet në rastin e letërporosive të parashikuara nga neni 13 pika 1 shkronja “d” të këtij ligji.

Neni 16

Prania e autoriteteve gjyqësore të huaja në marrjen e provave

1. Autoriteti gjyqësor vendas, me kërkesë të shprehur të autoritetit gjyqësor të huaj, jep informacion për kohën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë.

2. Gjykata mund të lejojë përfaqësues të autoriteteve gjyqësore të huaja të marrin pjesë në marrjen e provës dhe që t'i drejtojnë pyetje personit që pyetet, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 17

Procedura e posaçme

Nëse autoriteti gjyqësor i huaj kërkon në letërporosi plotësimin e kushteve të veçanta, lidhur me formën dhe procedurën, autoriteti gjyqësor vendas vepron për ekzekutimin e saj në përputhje me këto kërkesa, me kusht që kërkesat të mos jenë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Dokumentimi i njoftimit

Autoritetet gjyqësore vendase dokumentojnë kryerjen e njoftimit të kërkuar nga autoritetet e huaja në përputhje me rregullat e njoftimit të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 19

Paprekshmëria e personit të thirrur

1. Kur personi, për të cilin kërkohet njoftimi për t'u thirrur në procedim në Shqipëri, nuk arrin të veprojë në përputhje me aktin e thirrjes, të lëshuar nga shteti kërkues, ndaj tij nuk ndërmerret asnjë masë detyruese, shtrënguese apo sanksion penal.

2. Nëse autoritetet gjyqësore vendase thërrasin një dëshmitar ose ekspert me vendbanim ose vendqëndrim jashtë shtetit, ai, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, nuk do t'i nënshtrohet procedimit penal për një vepër të kryer përpara paraqitjes në territorin shqiptar dhe as do të dërgohet të vuajë një dënim penal të dhënë me një vendim gjyqësor vendas, të dhënë përpara paraqitjes së tij.

3. Pika 2 e këtij neni nuk zbatohet nëse dëshmitari apo eksperti, edhe pse i është dhënë mundësia, nuk është larguar nga territori shqiptar brenda 15 ditëve pasi ai është njoftuar se prania e

tij nuk është më e nevojshme. Ky afat nuk përfshin periudhën gjatë së cilës dëshmitari apo eksperti nuk mund të largohet nga territori shqiptar për shkaqe të ligjshme të dokumentuara.

Neni 20

Seancat dëgjimore nëpërmjet lidhjes telefonike ose audiovizive

1. Autoritetet gjyqësore vendase mund t'i drejtojnë kërkesë autoriteteve gjyqësore të huaja për pyetjen në distancë të dëshmitarit ose ekspertit të ndodhur jashtë shtetit, nëpërmjet lidhjeve telefonike ose audiovizive.

2. Kërkesa drejtuar autoritetit gjyqësor të huaj për zhvillimin e seancës nëpërmjet lidhjeve telefonike ose audiovizive, krahas informacionit të parashikuar nga pika 1 i nenit 5 të këtij ligji, duhet të përmbajë:

- a) emrin e autoritetit gjyqësor vendas dhe të personave që do të drejtojnë seancën dëgjimore;
- b) arsyen pse nuk është e mundur pjesëmarrja personalisht e dëshmitarit apo ekspertit.

3. Autoritetet gjyqësore vendase ekzekutojnë letërporositë e huaja me objekt zhvillimin e seancave dëgjimore nëpërmjet lidhjeve telefonike ose audiovizive kur:

- a) dëshmitari ose eksperti nuk dëshiron apo nuk ka mundësi të paraqitet tek autoritetet gjyqësore të huaja, si dhe ka dhënë pëlqimin për zhvillimin e seancës në këtë formë;
- b) gjykata kompetente ka miratuar kërkesën e shtetit kërkues për zhvillimin e seancës në këtë formë.

4. Pyetja e dëshmitarëve ose e ekspertëve në distancë kryhet nga autoritetet gjyqësore vendase duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 21

Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar

1. Kur autoriteti gjyqësor i huaj thërret për të pyetur një person të ndaluar në Shqipëri, ai mund të transferohet përkohësisht në shtetin kërkues.

2. Transferimi i përkohshëm i personit vendoset nga Ministri i Drejtësisë, nëse shteti kërkues jep garanci për mbrojtjen dhe kthimin e personit brenda periudhës së përcaktuar.

3. Transferimi refuzohet kur:

- a) personi i ndaluar nuk jep pëlqimin e tij. Në rast se personi i ndaluar e ka dhënë pëlqimin, ai nuk mund ta revokojë atë;
- b) transferimi mund të zgjasë ndalimin e tij;
- c) ka arsye të tjera thelbësore për të mos e transferuar atë.

4. Kur prania e personit të ndaluar është e nevojshme në procedimet penale që zhvillohen nga autoritetet gjyqësore vendase, transferimi mund të shtyhet.

5. Kur një shteti të tretë i kërkohet të transferojë një person të ndaluar përmes territorit shqiptar, kalimi transit i tij lejohet nëse nuk është shtetas shqiptar.

6. Zyra e Interpolit, në bashkëpunim me autoritetin homolog të shtetit kërkues, merr masat teknike për të realizuar dorëzimin e personit të ndaluar dhe njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë për vendin dhe datën e dorëzimit të të transferuarit të përkohshëm. Dorëzimi i personit të transferuar kryhet nga Zyra e Interpolit, e cila menjëherë njofton Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

7. Koha e ndalimit në shtetin kërkues llogaritet në masën e dënimit që vuhet në Shqipëri.

8. Rregullat e parashikuara nga ky nen zbatohen edhe ndaj personit të ndaluar në territorin shqiptar apo që është transferuar për të vuajtur dënimin e dhënë nga shteti kërkues, kur paraqitja e tij personale është kërkuar për efekt të rishikimit të vendimit nga shteti kërkues.

Neni 22

Kontrolli dhe sekuestrimi i sendeve

1. Me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të huaja, autoriteti gjyqësor vendas mund të vendosë lejin e kontrollit të vendeve ose sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me faktet e përcaktuara në letërporosi. Vendimi mund të ankimohej brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

2. Autoriteti gjyqësor vendas kompetent kryen kontrollin dhe sekuestrimin në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Kur një palë e tretë, që ka fituar të drejta në mirëbesim, një autoritet shtetëror apo një palë e dëmtuar, që ka vendbanimin ose vendqëndrim në Shqipëri, pretendon pronësinë mbi sendet, dokumentet apo fitimet, sendet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dërgohen vetëm nëse autoriteti gjyqësor i huaj garanton kthimin e tyre në fund të procedimeve në lidhje me provat.

4. Dërgimi mund të shtyhet për aq kohë sa sendet, dokumentet apo fitimet janë të nevojshme për procedimet penale të filluara në Shqipëri.

Neni 23

Dorëzimi i sendeve të sekuestruara

1. Sendet e sekuestruara i dërgohen autoritetit të huaj gjyqësor me kërkesën e tij, në ekzekutim të letërporosisë, për t'u konfiskuar ose për t'u kthyer pronarit të ligjshëm.

2. Këto sende përfshijnë:

a) sendet e përdorura për kryerjen e një vepre penale;

b) sendet që rrjedhin nga kryerja e një vepre penale apo vlera e barabartë me to;

c) fitimet nga një vepër penale apo vlera e barabartë me to;

ç) sende të tjera të dhëna me qëllim nxitjen për kryerjen e një vepre penale, si edhe shpërblimet për një vepër penale.

3. Sendet apo fitimet mund të mbahen në mënyrë të përhershme në Shqipëri nëse:

a) pronari i tyre ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë;

b) ka pretendime serioze të autoriteteve shtetërore shqiptare në lidhje me sendet apo fitimet;

c) personi, i cili nuk ka marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale dhe pretendimet e të cilit nuk garantohen nga shteti kërkues, provon se ka fituar të drejta mbi këto sende dhe fitime, në mirëbesim, si edhe që personi ka vendbanimin në Shqipëri.

Neni 24

Shtyrja e ekzekutimit të kërkesave

1. Autoriteti gjyqësor vendas mund të shtyjë ose të kushtëzojë ekzekutimin e kërkesave nëse ai mund të ndikojë në mbarëvajtjen e procedimeve penale të filluara nga autoritetet gjyqësore vendase.

2. Autoriteti gjyqësor vendas njofton autoritetin gjyqësor të huaj, duke deklaruar arsyet e shtyrjes ose kushtëzimit. Në rast se njoftimi kryhet drejtpërdrejt tek autoriteti gjyqësor i huaj, autoriteti gjyqësor vendas njofton njëkohësisht edhe Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 25

Shpenzimet

1. Shteti shqiptar, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, mund të heqë dorë nga rimbursimi i shpenzimeve të ekzekutimit të letërporosive nga shteti kërkues.

2. Shpenzimet e ekzekutimit të letërporosive vendase paguhen nga autoriteti gjyqësor vendas që ka kërkuar letërporosinë.

3. Një dëshmitar ose ekspert që paraqitet në ekzekutim të një letërporosie të autoriteteve gjyqësore vendase ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit, të cilat dokumentohen si pjesë e shpenzimeve procedurale në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

4. Në rast se letërporosia e autoritetit gjyqësor vendas ka objekt dhënien e dëshmisë së ekspertit, atëherë autoriteti gjyqësor vendas mund të depozitojë paraprakisht një shumë për mbulimin e shpenzimeve të dëshmisë së ekspertit nëse autoriteti gjyqësor i huaj e kërkon shprehimisht një gjë të tillë.

5. Letërporositë e autoriteteve gjyqësore vendase, në rastet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni, tregojnë shpenzimet e pagueshme dhe ato të rimbursueshme. Me kërkesë me shkrim të personave të thirrur, atyre u jepet paraprakisht një shumë për të mbuluar shpenzimet.

6. Autoritetet gjyqësore vendase nuk paguajnë shpenzimet e ekzekutimit të letërporosive të huaja për:

a) udhëtimin dhe qëndrimin e personave të thirrur për t'u pyetur apo për të kryer një veprim procedural;

b) transferimin e përkohshëm të personave të ndaluar;

c) zhvillimin e seancave dëgjimore nëpërmjet lidhjeve telefonike ose audiovizive;

ç) ruajtjen apo administrimin e provave apo sendeve;

d) kryerjen e veprimeve procedurale me shpenzime të larta apo të jashtëzakonshme.

Neni 26

Masat paraprake

Me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të huaja dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm, autoriteti gjyqësor vendas merr masa paraprake për ruajtjen e provave, të sendeve të konfiskueshme, të situatës ekzistuese ose mbrojtjes së interesave ligjorë të rrezikuar.

Neni 27

Përcjellja e të dhënave pa kërkesë

1. Autoritetet gjyqësore vendase edhe kryesisht i përcjellin autoriteteve gjyqësore të huaja informacion që lidhet me veprat penale, të mbledhur gjatë procedimit penal, nëse ato vlerësojnë se përcjellja e një informacioni të tillë mund të ndihmojë në fillimin e një procedimi penal apo në paraqitjen e një kërkesë për ndihmë juridike nga shteti i huaj. Përcjellja e këtij informacioni bëhet nëse nuk pengohet ecuria e procedimit penal në Shqipëri dhe duke respektuar kushtet e reciprocitetit.

2. Autoriteti gjyqësor kompetent vendas mund të kërkojë nga autoritetet gjyqësore të huaja, që kanë marrë informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, të dhëna për masat e marra në lidhje me informacionin e përcjellë. Gjithashtu, autoriteti gjyqësor kompetent vendas mund të vendosë kushte të tjera në lidhje me përdorimin e këtij informacioni në shtetin, të cilit i është përcjellë informacioni.

Neni 28

Përcjellja e informacionit për shtetasit e huaj të proceduar ose të dënuar

1. Ministria e Drejtësisë çdo tre muaj i dërgon informacion autoritetit gjyqësor të huaj për vendimet penale të formës së prerë, të dhëna ndaj shtetasve të atij shteti. Ky informacion nxirret nga regjistri i gjendjes gjyqësore.

2. Me kërkesën e autoriteteve kompetente gjyqësore të huaja, Ministria e Drejtësisë përcjell shkurtimin e vendimit penal të formës së prerë ose vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

3. Me kërkesën e një shteti të huaj, Ministria e Drejtësisë mund të përcjellë të dhëna për personat që janë shtetas të shtetit kërkues dhe që janë subjekte të një procedimi penal të filluar në Republikën e Shqipërisë. Për plotësimin e kësaj kërkesë, Ministria e Drejtësisë bashkëpunon me Prokurorin e Përgjithshëm.

Neni 29

Regjistri gjyqësor penal i shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit

1. Zyra e Regjistrat Gjyqësor regjistron në një regjistër të posaçëm shkurtimeve të vendimeve për shtetasit shqiptarë të dënuar penalisht jashtë shtetit, duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë të lindur jashtë shtetit. Për këtë qëllim krijohet një regjistër i posaçëm pranë kësaj zyre.

2. Nëse autoritetet gjyqësore të huaja përcjellin informacionin për dënimin e shtetasve shqiptarë në gjuhë të huaj, përkthimi i tyre realizohet nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet shërbimit të përkthimit zyrtar.

3. Për përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e informacionit, si dhe për heqjen e shënimeve në këtë regjistër zbatohen rregullat e legjislacionit të brendshëm.

Neni 30

Njoftimet për legjislacionin

1. Me kërkesën e autoriteteve gjyqësore vendase, Ministria e Drejtësisë merr tekstin e legjislacionit në fuqi në shtete të tjera, si edhe çdo informacion për çështje të posaçme juridike, nëse kjo është e nevojshme.

2. Ministria e Drejtësisë i përcjell tekstin e legjislacionit të brendshëm ose informacionin për çështje të posaçme juridike autoriteteve të huaja gjyqësore kur kërkohet prej tyre.

KREU III EKSTRADIMI

SEKSIONI I EKSTRADIMI NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 31

Ligji i zbatueshëm

Dorëzimi i një personi nën hetim, të pandehur apo të dënuar, në drejtim të një shteti të huaj kryhet sipas këtij ligji, rregullave të legjislacionit shqiptar dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 32

Kushtet për ekstradimin

Përveç kushteve të parashikuara në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, ekstradimi i një personi në drejtim të një shteti të huaj lejohet kur plotësohen edhe kushtet e mëposhtme:

a) legjislacioni shqiptar parashikon për veprën penale, për të cilën shteti i huaj ka caktuar masën shtrënguese të sigurimit, një dënim me burgim jo më të ulët se një vit;

b) masa ose pjesa e mbetur e dënimit të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë është të paktën 4 muaj në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim;

c) ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit kërkues;

ç) janë kushtet për rifillimin e procedimit penal në shtetin kërkues, megjithëse procedimi penal në Shqipëri, për të njëjtën veprë penale, ka pushuar;

d) shteti kërkues jep garanci që nuk do të japë një dënim me vdekje ose nëse e ka dhënë një dënim të tillë, nuk do ta ekzekutojë atë.

dh) personi, për të cilin kërkohet ekstradimi, në kohën e paraqitjes së kërkesës për ekstradim, nuk ka aplikuar apo nuk i është dhënë azil në Shqipëri ndaj shtetit kërkues.

Neni 33

Veprimet e Ministrisë së Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë, kur nuk e refuzon kërkesën për ekstradim, ia përcjell aktet brenda 10 ditëve prokurorit pranë gjykatës kompetente, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm. Në raste të ndërlikuara, për shkak të vëllimit të akteve apo të nevojës për përkthim, ky afat mund të zgjatet deri në 15 ditë.

2. Ministria e Drejtësisë, nëse konstaton se kërkesës për ekstradim nuk i janë bashkëngjitur të gjitha aktet e nevojshme, por gjithsesi arrin në përfundimin që nuk është rasti për refuzimin e kërkesës, vepron sipas nenit 11 të këtij ligji. Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkuar i përcillen organit të prokurorisë brenda 7 ditëve nga marrja e tyre, duke respektuar edhe detyrimin për përkthim.

3. Ministria e Drejtësisë vepron në të njëjtën mënyrë edhe në rast se i paraqitet kërkesë për plotësim aktesh nga autoritetet gjyqësore vendase.

Neni 34

Veprimet e prokurorisë

1. Prokurori, pas marrjes së kërkesës për ekstradim, brenda 10 ditëve urdhëron thirrjen e të interesuarit, me qëllim identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventuale për ekstradimin.

2. Urdhri i thirrjes së prokurorit përmban:

a) të dhëna për kohën dhe vendin e paraqitjes;

b) të drejtën për të zgjedhur një mbrojtës;

c) arsyen e thirrjes me një përmbledhje të shkurtër të fakteve; si dhe

ç) paralajmërimin për shoqërimin e detyrueshëm të personit, në rast mosparaqitjeje të personit pa shkaqe të ligjshme.

3. Prokurori dokumenton veprimet me personin e interesuar me procesverbal, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

4. Në vijim, prokurori respekton rregullat e Kodit të Procedurës Penale për paraqitjen e kërkesës në gjykatë.

Neni 35

Masat shtrënguese dhe sekuestrimet

1. Ministria e Drejtësisë, me marrjen e një urdhri ndërkombëtar arresti nga Zyra e Interpolit, në të cilin deklarohet qëllimi i shtetit kërkuar për ekstradimin e shtetasit të huaj, brenda 5 ditëve ia përcjell Prokurorit të Përgjithshëm për të vepruar sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

2. Ministria e Drejtësisë vepron në të njëjtën mënyrë edhe me marrjen e një kërkesë nga shteti kërkuar për vendosjen e masave të tjera shtrënguese apo për sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që janë përfitim i veprës penale, për të cilën është kërkuar apo do të kërkohej ekstradimi.

3. Prokurori i Përgjithshëm ia dërgon aktet prokurorit pranë gjykatës kompetente, që ky i fundit të depozitojë kërkesën në gjykatë jo më vonë se 15 ditë nga koha e paraqitjes së kërkesës së shtetit kërkuar.

4. Gjykata, për caktimin e masave shtrënguese dhe të sekuestrimit, respekton rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

5. Masat shtrënguese dhe sekuestrimi caktohen nëse urdhri ndërkombëtar i arrestit ose kërkesa e shtetit të huaj përmban:

a) gjenealogjet e shtetasit të huaj;

b) të dhënat mbi autoritetin gjyqësor të huaj që ka lëshuar urdhrin ndërkombëtar të arrestit ose një kopje të aktit, me të cilin është urdhëruar masa shtrënguese apo sekuestrimi;

c) të dhënat mbi veprën penale, për të cilën kërkohej masa shtrënguese ose sekuestrimi; dhe

ç) deklarimin e shtetit kërkues se do të paraqitet një kërkesë për ekstradim.

6. Prokurori i Përgjithshëm njofton Ministrinë e Drejtësisë për caktimin e masave shtrënguese dhe sekuestrimet, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit gjyqësor.

7. Ministria e Drejtësisë njofton shtetin kërkues brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit gjyqësor.

8. Masat shtrënguese revokohen sipas afateve të përcaktuara në nenet 493 pika 4 dhe 494 pika 6 të Kodit të Procedurës Penale. Këto afate fillojnë të ecin nga koha e përcaktuar në këto nene, edhe në rast se personi, për të cilin kërkohet ekstradimi, është i ndaluar në bazë të një vendimi tjetër gjyqësor.

9. Kur masat shtrënguese, të caktuara përpara paraqitjes së kërkesës për ekstradim, revokohen për shkak të mbarimit të afateve, ndaj personit nuk mund të caktohet përsëri masë shtrënguese, përveçse kur shteti kërkues paraqet kërkesën për ekstradim.

Neni 36

Arrestimi nga policia gjyqësore

1. Në rastet e ngutshme të arrestimit të personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm, zbatohen rregullat e nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë realizon përkthimin e akteve të kërkuara brenda 24 orëve.

Neni 37

Shqyrtimi i kërkesës për ekstradim

1. Brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit, gjyqtari i caktuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim.

2. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur nuk paraqitet, gjykata cakton një mbrojtës kryesisht.

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, gjykata respekton rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 38

Urdhri ndërkombëtar i arrestit të shtetasve shqiptarë

1. Zyra e Interpolit, me marrjen e një urdhri ndërkombëtar arresti nga një shtet i huaj kundër një shtetasi shqiptar, në të cilin deklarohet qëllimi i shtetit kërkues për ekstradimin e personit, menjëherë dhe gjithsesi, brenda 5 ditëve, ia përcjell Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga marrja e urdhrit ndërkombëtar, ia përcjell atë Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente për procedimin penal të shtetasit shqiptar, mund të procedojë për arrestimin e përkohshëm të shtetasit shqiptar, duke respektuar rregullat e neneve 493-495 të Kodit të Procedurës Penale dhe të neneve 35 e 36 të këtij ligji.

4. Prokurori i Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e urdhrit ndërkombëtar prej Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore:

a) verifikon gjenealogjetet e sakta të shtetasit shqiptar të kërkuar, duke përfshirë edhe shtetësinë e tij;

b) merr të dhëna për vendndodhjen e saktë të shtetasit shqiptar të kërkuar;

c) verifikon nëse shtetasi shqiptar është i dënuar me vendim penal me burgim të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore vendase;

ç) verifikon nëse ndaj shtetasit shqiptar është caktuar një masë sigurimi shtrënguese për efekte të një procedimi penal nga autoritetet gjyqësore vendase.

5. Prokurori i Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga përfundimi i veprimeve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, njofton Ministrinë e Drejtësisë për pamundësinë e ekstradimit të shtetasit shqiptar për shkak të shtetësisë së tij. Ky njoftim përmban edhe informacionin për mënyrat e procedimit penal, të pranura nga legjislacioni shqiptar, sipas rastit nëpërmjet:

- a) transferimit të procedimeve penale;
- b) njohjes së vendimit penal të huaj; ose
- c) dërgimit të akteve dhe provave nëpërmjet letërporosive.

6. Ministria e Drejtësisë, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas pikës 4 të këtij neni, ia përcjell atë shtetit të huaj që ka lëshuar urdhrin ndërkombëtar të arrestit.

7. Prokurori pranë gjykatës kompetente për procedimin penal të shtetasit shqiptar, nëse nuk procedon sipas pikës 3 të këtij neni, shënon në regjistrin e njoftimeve të veprave penale të dhënat e urdhrin ndërkombëtar të arrestit, me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale verifikuese për fillimin e procedimit penal. Në rast se prokurori vendos mosfillimin e procedimit penal, ia njofton këtë vendim Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

8. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe nëse shtetësia shqiptare e personit vërtetohet gjatë caktimit dhe zbatimit të masave shtrënguese.

9. Rregullat e këtij neni nuk zbatohen në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare që lejojnë ekstradimin e shtetasit shqiptar.

Neni 39

Vendimi i gjykatës për ekstradimin

1. Përveç kushteve të vendosura në nenin 498 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 11 të Kodit Penal, gjykata jep vendim në favor të ekstradimit, kur konstaton se janë plotësuar edhe kushtet e nenit 32 të këtij ligji.

2. Në rastet e tjera, gjykata vendos kundër ekstradimit.

3. Vendimi gjyqësor i dhënë sipas këtij neni depozitohet në sekretarinë gjyqësore brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Neni 40

Disponimi i Ministrit të Drejtësisë për ekstradimin

1. Prokurori i Përgjithshëm, brenda 7 ditëve nga data e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor për ekstradimin, ia përcjell të gjitha aktet Ministrit të Drejtësisë.

2. Në rast të një vendimi gjyqësor në favor të kërkesës për ekstradim, Ministri i Drejtësisë, pas verifikimit dhe vlerësimit të të gjithë dokumentacionit, mund të disponojë me urdhër ekstradimin duke respektuar afatin dhe procedurat e nenit 499 të Kodit të Procedurës Penale.

3. Nëse Ministri i Drejtësisë, gjatë verifikimit të dokumentacionit, konstaton mangësi të akteve, brenda 7 ditëve i kërkon Prokurorit të Përgjithshëm plotësimin e tyre. Prokurori i Përgjithshëm plotëson dokumentacionin brenda 20 ditëve nga data e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor.

4. Në rast se Ministri i Drejtësisë nuk disponon brenda afatit për ekstradimin ose në rast të një vendimi gjyqësor kundër ekstradimit apo në rast të mosveprimit në kohë të shtetit kërkuar zbatohen rregullat e nenit 499 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 41

Ekstradimi i shtyrë ose i kushtëzuar

1. Ministri i Drejtësisë, në rastin kur ekstradimi pezullohet sipas nenit 500 të Kodit të Procedurës Penale, mund të disponojë me urdhër dorëzimin e shtyrë në kohë të të ekstraduarit pas përfundimit të procedimit penal apo të ekzekutimit të dënimit penal të dhënë në Shqipëri.

2. Prokurori i Përgjithshëm, të paktën 30 ditë përpara përfundimit të shkakut të pezullimit, njofton Ministrin e Drejtësisë. Pas këtij njoftimi, Ministri i Drejtësisë njofton shtetin kërkues nëse ky i fundit ka ende interes për realizimin e ekstradimit.

3. Nëse shteti kërkues njofton se ka interes për realizimin ekstradimit, Ministri i Drejtësisë vepron sipas nenit 40 të këtij ligji.

4. Ministri i Drejtësisë mund të disponojë me urdhër ekstradimin e përkohshëm të personit me kushte të përcaktuara në marrëveshje të shprehur me shtetin kërkues. Ekstradimi i përkohshëm disponohet për kryerjen e veprimeve urgjente procedurale, nëse një gjë e tillë nuk pengon procedimin penal apo ekzekutimin e vendimit penal në Shqipëri dhe nëse shteti kërkues jep garanci se personi i ekstraduar do të ruhet dhe do të kthehet në Shqipëri brenda afatit të përcaktuar paraprakisht.

Neni 42

Parimi i specialitetit

1. Ministri i Drejtësisë përcakton në urdhrin që disponon ekstradimin e një shtetasi të huaj kërkesën për respektimin e parimit të specialitetit. Për këtë qëllim, në fillim të procedurës së ekstradimit dhe kur garancitë nuk janë dhënë, Ministri i Drejtësisë kërkon nga shteti kërkues që:

a) i ekstraduari nuk duhet të ndiqet penalisht për një vepër tjetër penale të kryer përpara ekstradimit;

b) i ekstraduari nuk duhet t'i nënshtrohet ekzekutimit të një vendimi për një vepër tjetër penale të kryer përpara ekstradimit;

c) ndaj të ekstraduarit nuk duhet të zbatohet një dënim më i rëndë sesa dënimi me të cilin ai është dënuar dhe as dënimi me vdekje;

ç) i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij; dhe

d) i ekstraduari nuk duhet të ekstradohet drejt një shteti të tretë, pa pëlqimin e Republikës së Shqipërisë, për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për dënimin me burgim ose për ekzekutimin e një mase sigurimi shtrënguese të karakterit personal për kufizimin e lirisë, të dhënë përpara se ekstradimi të lejohej.

2. Ky parim nuk respektohet në rastet e parashikuara nga neni 490 pikat 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 43

Njoftimi i urdhrin të Ministrin të Drejtësisë që disponon ekstradimin

1. Ministri i Drejtësisë ia komunikon menjëherë shtetit kërkues dhe Ministrisë së Brendshme urdhrin që disponon ekstradimin e një shtetasi të huaj.

2. Zyra e Interpolit, në bashkëpunim me autoritetin homolog të shtetit kërkues, merr masat teknike për të realizuar dorëzimin dhe njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë për vendin dhe datën e dorëzimit të të ekstraduarit. Dorëzimi i të ekstraduarit kryhet nga Zyra e Interpolit, e cila menjëherë njofton Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm.

Neni 44

Ekstradimi i thjeshtuar

1. Personi, për të cilin kërkohet ekstradimi, mund të japë pëlqimin që të dorëzohet vetë te shteti kërkues dhe për heqjen dorë nga e drejta për të përfituar nga parimi i specialitetit përmes një procedure të thjeshtuar. Pëlqimi dhe heqja dorë janë të parevokueshme.

2. Ky pëlqim jepet nga personi në seancë gjyqësore, e cila zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Gjykata informon personin për avantazhet, pasojat e ekstradimit të thjeshtuar dhe për pamundësinë e revokimit të pëlqimit dhe heqjes dorë. Në këtë rast nuk zhvillohet gjykim për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim.

3. Prokurori i Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga zhvillimi i kësaj seance, njofton Ministrinë e Drejtësisë mbi pëlqimin për ekstradimin e thjeshtuar, duke i dërguar kopje të procesverbalit gjyqësor që dokumenton këtë seancë. Ministri i Drejtësisë njofton shtetin kërkues brenda 10 ditëve nga zhvillimi i seancës.

4. Në vijim zbatohen rregullat për ekstradimin e zakonshëm.

Neni 45 **Riekstradimi**

1. Kur shteti kërkues riparaqet kërkesë për riekstradimin e personit, i cili pas ekstradimit të parë i është shmangur procedimit penal ose ekzekutimit të dënimit penal në shtetin kërkues dhe ka hyrë në territorin shqiptar, personi mund të riekstradohet mbi bazën e një kërkesë të përsëritur, duke zbatuar rregullat e këtij seksioni.

2. Në këtë rast, Ministri i Drejtësisë, pasi merr edhe mendimin e Prokurorit të Përgjithshëm, mund të njoftojë shtetin kërkues se nuk është e nevojshme riparaqitja e dokumenteve që shoqërojnë kërkesën për ekstradim, me përjashtim të dokumentit që provon shmangien e të ekstraduarit nga procedimi penal ose ekzekutimi i dënimit penal.

Neni 46 **Përsëritja e procedurave gjyqësore**

Nëse pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor mbi kërkesën për ekstradim, por përpara nxjerrjes së urdhrit të ministrit për disponimin mbi ekstradimin, ndryshojnë kushtet e ekstradimit të parashikuara në nenin 32 të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm fashikullin e plotë, duke i kërkuar të iniciojë rishikimin e vendimit gjyqësor. Në këtë rast zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 47 **Dorëzimi i sendeve të sekuestruara**

1. Sendet e sekuestruara, sipas këtij seksioni, i dorëzohen shtetit kërkues me kërkesë të tij pas disponimit të ekstradimit.

2. Dorëzimi i sendeve mund të bëhet edhe nëse i ekstraduari nuk dorëzohet për shkak të vdekjes ose sëmundjes së rëndë, por me kusht që ekstradimi i tij të jetë disponuar.

3. Nëse këto sende i janë nënshtruar sekuestrimit ose konfiskimit, për qëllime të një procedimi gjyqësor në Shqipëri, ato mund të mbahen përkohësisht deri në përfundimin e procedimit gjyqësor, ose mund t'i dorëzohen shtetit kërkues, me kusht që ato të kthehen.

4. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në rastet e parashikuara nga shkronjat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 23 të këtij ligji.

SEKSIONI II **EKSTRADIMI NGA JASHTË SHTETIT**

Neni 48 **Shpallja në kërkim ndërkombëtar**

1. Prokurori i ekzekutimit, nëse ka të dhëna se i dënuari nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllime të ekzekutimit të vendimit penal me burgim të formës së prerë.

2. Prokurori i çështjes, nëse ka të dhëna se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllim të ekzekutimit të masës së sigurimit për kufizimin e lirisë personale.

3. Urdhri i kërkimit ndërkombëtar përmban:

- a) prokurorin që ka lëshuar urdhrin e kërimit;
 - b) gjenealogjet e personit që kërkohet dhe çdo e dhënë tjetër, e vlefshme për identifikimin e tij;
 - c) gjykatën dhe të dhëna për vendimin gjyqësor që ka caktuar masën e sigurimit ose ka dhënë vendimin penal të dënimit;
 - ç) kohëzgjatjen e masës së sigurimit, kur ajo është caktuar me afat ose kohën e mbetur të masës së dënimit;
 - d) emërtimin e veprës penale dhe një përshkrim të përmbledhur të faktit penal;
 - dh) deklarin se ky person kërkohet për qëllime të ekstradimit.
4. Prokurori ia dërgon menjëherë urdhrin e kërimit ndërkombëtar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ia përcjell Zyrës së Interpolit për komunikimin ndërkombëtar të urdhrin.
5. Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Brendshëm, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë procedurat e nxjerrjes së urdhrin të kërimit ndërkombëtar, si dhe rregulla të detajuara për afatet dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit për nxjerrjen dhe komunikimin e tij.

Neni 49

Kërkesa për ekstradim

1. Kur ndaj një personi që gjendet jashtë shtetit është caktuar një masë sigurimi për kufizimin e lirisë në një procedim penal, ose nëse ndaj tij është dhënë një vendim dënimi me burgim i formës së prerë, Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë kërkesë për ekstradimin e tij, bazuar mbi informacionin dhe dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm.
2. Kërkesa duhet të plotësojë kushtet e nenit 5 të këtij ligji dhe i paraqitet shtetit të kërkuar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 50

Kërkesa për ndalim të përkohshëm

1. Në raste urgjente, nëse ka rrezik që personi, për të cilin kërkohet ekstradimi, të largohet ose të fshihet, Ministri i Drejtësisë, edhe para paraqitjes së kërkesës për ekstradim, mund të kërkojë që shteti i kërkuar të ndalojë përkohësisht personin.
2. Kërkesa për ndalim të përkohshëm përmban elementet e parashikuara në nenin 35 të këtij ligji.

Neni 51

Garancitë në lidhje me personin e ekstraduar

1. Kur personi i kërkuar ekstradohet, ai gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji, me përjashtim të rastit kur i ekstraduari ka hequr dorë nga këto të drejta dhe kur shteti i kërkuar e ka përcaktuar një gjë të tillë shprehimisht në kërkesë.
2. Kur ekstradimi në Republikën e Shqipërisë i një personi të kërkuar është dhënë sipas kushteve të caktuara, në lidhje me llojin ose afatin e dënimit që mund të jepet ose ekzekutohet dhe është pranuar me këto kushte, autoritetet gjyqësore vendase janë të detyruara t'i respektojnë këto kushte gjatë procedimit penal apo gjatë ekzekutimit të dënimit.
3. Kur i ekstraduari është ndaluar në shtetin e kërkuar për veprën penale për të cilën ai është ekstraduar, koha që ai ka kaluar në ndalim llogaritet në masën e dënimit.
4. Vendimi penal i formës së prerë, i dhënë ndaj personit të ekstraduar nga autoritetet gjyqësore vendase, në mungesë të tij, mund të rishikohet me kërkesë të të ekstraduarit, nëse Ministri i Drejtësisë i ka dhënë një garanci të tillë shtetit të kërkuar. Kërkesa për rishikim paraqitet brenda 30 ditëve nga mbërritja e të ekstraduarit në territorin shqiptar dhe shqyrtimi i saj ndjek rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 52

**Kërkesa për transit nëpër territorin
e Republikës së Shqipërisë dhe shpenzimet**

Në rastin e kalimit transit përmes territorit shqiptar të një personi të ekstraduar nga një shtet në tjetrin zbatohen rregullat e nenit 502 të Kodit të Procedurës Penale.

KREU IV

NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

SEKSIONI I

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE TË HUAJA

Neni 53

Dispozita të përgjithshme

1. Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet gjyqësore vendase, për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, zbatojnë rregullat e Kodit të Procedurës Penale dhe të këtij ligji.

2. Vendimi i një gjykate të huaj për dënimin me burgim mund të njihet:

a) me kërkesë të shtetit dënues, kur personi i dënuar është shtetas shqiptar dhe ka vendbanim ose vendqëndrim në Shqipëri; dhe

b) me kërkesën e një shtetasi shqiptar që vuan dënimin në shtetin dënues, për transferim dhe vazhdim të vuajtjes së dënimit në Shqipëri.

3. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një kërkesë për njohje të një vendimi penal të huaj nga shteti dënues në gjuhë të huaj, mund t'i kërkojë shtetit dënues përkthimin e saj në gjuhën shqipe. Në rast se përkthimi kryhet nga Ministria e Drejtësisë, shpenzimet e përkthimit evidentohen për t'u përfshirë si pjesë e shpenzimeve procedurale.

4. Ministria e Drejtësisë ia dërgon aktet brenda 30 ditëve nga marrja e tyre prokurorit të rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Prokurori paraqet kërkesën në gjykatë brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. Nëse gjykata që ka marrë aktet konstaton që nuk ka kompetencë për të marrë vendim, ajo shpall moskompetencën e saj dhe ia dërgon aktet gjykatës kompetente, duke njoftuar njëkohësisht Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 54

Kërkesat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja

Përveç kushteve të parashikuara në nenin 514 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi penal i huaj njihet dhe ekzekutohet edhe kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e paraqitjes së kërkesës për njohje në Ministrinë e Drejtësisë, personit të dënuar i kanë mbetur për të vuajtur të paktën edhe gjashtë muaj burgim;

b) ekzekutimi i vendimit të dënimit, në bazë të legjislacionit të brendshëm, nuk është parashkruar.

Neni 55

Dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës së shtetit dënues

1. Ministria e Drejtësisë i paraqet shtetit dënues kërkesën për plotësim dokumentacioni, pa ia përcjellë aktet autoriteteve gjyqësore vendase, nëse kërkesa e shtetit kërkues nuk shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) origjinalin ose kopje të njësuar të vendimit penal me përcaktimin që është i formës së prerë;

b) gjenealogjet e personit të dënuar, duke përfshirë edhe të dhënat për shtetësinë, vendbanimin dhe vendqëndrimin, vendlindjen, si dhe të dhëna të tjera që mund të jenë të rëndësishme për përcaktimin e gjykatës kompetente që do të vendosë mbi kërkesën;

c) të dhëna për ekzekutimin e vendimit të dhënë, duke përfshirë informacionin për kohën e kaluar në ndalim dhe/ose duke vuajtur dënimin me burgim;

ç) një kopje të dispozitave ligjore, ku bazohet vendimi që kërkohet të njihet;

d) një paraqitje e përmbledhur e ecurisë së procedimit penal.

2. Kur Ministria e Drejtësisë konstaton që dokumentacioni është i plotë, brenda 20 ditëve ia dërgon prokurorit kompetent, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Nëse shteti dënues nuk paraqet dokumentet e kërkuara brenda tre muajve, kërkesa dhe aktet i kthehen shtetit dënues. Megjithatë procedura rifillon në rast të riparaqitjes së kërkesës dhe akteve të plotësuara nga shteti dënues.

4. Kërkesa për plotësim dokumentacioni mund të paraqitet edhe nga autoritetet gjyqësore vendase, nëse ato konstatojnë gjatë shqyrtimit të kërkesës një gjë tilla. Kjo kërkesë përcillet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë. Ky rregull nuk zbatohet nëse në një marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme parashikohet ndryshe.

Neni 56

E drejta e mbrojtjes me avokat

Gjatë gjykimit, personi ndaj të cilit kërkohet njohja dhe ekzekutimi i një vendimi penal të huaj, ka të drejtën e mbrojtjes të zgjedhur ose të caktuar, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 57

Mënyra e procedimit nga gjykata

1. Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit, gjyqtari i çështjes cakton datën e seancës gjyqësore dhe urdhëron njoftimin e palëve.

2. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësit.

3. Në marrjen e vendimit për kërkesën, gjykata merr parasysh faktet e konstatuara në vendimin e huaj.

4. Në caktimin e dënimit, gjykata respekton kushtet e nenit 516 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbështetet në legjislacionin penal shqiptar, duke arsyetuar edhe rrethanat e vlerësuara.

5. Për depozitimin e vendimit në sekretari dhe njoftimin e tij zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

6. Vendimi mund të ankimohet në një gjykatë të një niveli më të lartë nga prokurori, i dënuari ose mbrojtësi i tij brenda 10 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij.

Neni 58

Përcjellja e vendimit

1. Prokurori i Përgjithshëm i përcjell Ministrisë së Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga marrja formë të prerë, kopjen e vendimit gjyqësor për njohjen e vendimit penal të huaj.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të njohjes nga Prokurori i Përgjithshëm, njofton shtetin dënues.

Neni 59

Ekzekutimi i vendimit penal të huaj

Vendimi penal i huaj, pas njohjes, ekzekutohet në përputhje me nenin 518 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 60

**Ekzekutimi i vendimeve të huaja në rastin e transferimit
për vazhdimin e vuajtjes së dënimit**

1. Shtetasi shqiptar që vuan një dënim me burgim në një shtet të huaj, me kërkesë të tij, mund të transferohet në Shqipëri për të vazhduar vuajtjen e dënimit me burgim pasi vendimi të jetë njohur nga autoritetet gjyqësore vendase.

2. Nëse shteti dënues paraqet aktin, me të cilin i dënuari ka marrë njoftim për vendimin e njohjes, Ministria e Drejtësisë ia përcjell këtë akt njoftimi Prokurorit të Përgjithshëm dhe gjykatës që ka dhënë vendimin e njohjes.

3. Pasi vendimi penal i huaj të jetë njohur dhe autoritetet kompetente të shtetit dënues të kenë pranuar transferimin e të dënuarit, fillon marrja e masave për transferimin e personit të dënuar nga shteti dënues në Shqipëri, duke u zbatuar, për aq sa është e mundur, rregullat për dorëzimin e personit të ekstraduar.

4. Mënyra e pagimit dhe ndarja e shpenzimeve të transferimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 61

Veprime gjatë ekzekutimit të vendimit

1. Vendimi gjyqësor i huaj, i njohur sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale dhe të këtij ligji, nuk mund të rishikohet nga gjykatat shqiptare.

2. Gjatë ekzekutimit, dënimi i dhënë me vendimin gjyqësor të huaj mund të ulet, falet ose amnistohet, sipas rregullave të legjislacionit shqiptar.

3. Në rast se dënimi ulet, falet apo amnistohet nga shteti dënues, Ministri i Drejtësisë, bazuar në parimin e reciprocitetit me shtetin dënues, i përcjell aktet e dërguara nga shteti dënues prokurorit të ekzekutimit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i ekzekutimit paraqet kërkesë në gjykatën që ka dhënë vendimin e njohjes, e cila deklaron me vendim, sipas rastit, uljen ose shuarjen e dënimit.

4. Ministria e Drejtësisë njofton shtetin dënues për rrethanat e parashikuara në këtë nen.

SEKSIONI II

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE SHQIPTARE JASHTË SHTETIT

Neni 62

Kushtet e ekzekutimit

1. Ministria e Drejtësisë, përveç kushteve të parashikuara në nenin 519 të Kodit të Procedurës Penale, kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale nga një shtet i huaj edhe kur:

a) vendimi penal i dhënë nga një autoritet gjyqësor vendas nuk mund të ekzekutohet brenda territorit shqiptar; ose

b) ekzekutimi i dënimit penal jashtë shtetit mund t'i shërbejë një rehabilitimi më të mirë social të personit të dënuar.

2. Në paraqitjen e kësaj kërkeje, Ministria e Drejtësisë bazohet në informacionin dhe dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 63

Procedura e paraqitjes së kërkesës

1. Kërkesa e paraqitur përpara një shteti të huaj, për ekzekutimin e vendimit penal të një gjykate vendase, shoqërohet me dokumentet e parashikuara nga neni 55 i këtij ligji.

2. Kërkesa paraqitet në gjuhën e shtetit, tek i cili kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit ose në një gjuhë tjetër të pranuar prej tij.

Neni 64

**Transferimi i shtetasve të huaj për vazhdimin e vuajtjes
së dënimit të dhënë në Shqipëri**

1. Për transferimin e shtetasit të huaj të dënuar me një vendim penal të dhënë në Shqipëri zbatohen rregullat e nenit 520 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Prokurori ia dërgon aktet Ministrisë së Drejtësisë brenda 10 ditëve nga zhvillimi i seancës.

3. Për dorëzimin e të dënuarit të shteti dënues, fillon marrja e masave duke u zbatuar, për aq sa është e mundur, rregullat për dorëzimin e personit të ekstraduar.

Neni 65

**Pasojat e pranimit të ekzekutimit në rastin e rishikimit
ose ndërprerjes së ekzekutimit të vendimit penal**

1. Nëse pas njohjes dhe fillimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor shqiptar jashtë shtetit, në Shqipëri është vendosur rishikimi i vendimit gjyqësor, ulja ose shuarja e dënimit, Prokurori i Përgjithshëm njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga marrja e informacionit dhe dokumenteve nga Prokurori i Përgjithshëm, njofton shtetin e kërkuar.

2. Nëse shteti i kërkuar njofton se ekzekutimi i vendimit të njohur prej tij është i pamundur të kryhet, Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm për këtë fakt dhe ekzekutimi vazhdon në Republikën e Shqipërisë.

KREU V

TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE PENALE

SEKSIONI I

TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE PENALE TE SHTETET E HUAJA

Neni 66

Transferimi i procedimit penal në një shtet të huaj

Kur personi dyshohet për kryerjen e një veprë penale të dënueshme, sipas ligjit penal shqiptar, Ministri i Drejtësisë, kur plotësohen kushtet e nenit 67 të këtij ligji, i kërkon shtetit të huaj të fillojë procedimin penal.

Neni 67

Kushtet e transferimit të procedimit penal

Transferimi i procedimit penal kërkohet kur:

a) personi i dyshuar ka vendbanimin ose vendqëndrimin në shtetin e kërkuar; dhe
b) nuk është i mundur ose i përshtatshëm procedimi i personit në Shqipëri për një ose më shumë nga shkaqet e mëposhtme:

i) personi i dyshuar është shtetas i shtetit të kërkuar ose shteti i kërkuar është shteti i tij i origjinës;

ii) personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim me burgim në shtetin e kërkuar;

iii) shteti i kërkuar ka filluar procedimin penal për të njëjtën vepër penale ose për vepra të tjera penale kundër personit të dyshuar;

iv) çmohet se transferimi i procedimit penal i shërben zgjidhjes së drejtë e të përshtatshme të çështjes dhe procesit të rregullt ligjor;

v) ekzekutimi i dënimit penal të dhënë në shtetin e kërkuar mund t'i shërbejë një rehabilitimi më të mirë social të personit të dënuar;

vi) nuk mund të sigurohet thirrja dhe pjesëmarrja e personit të dyshuar në procedimin penal në Shqipëri;

vii) ekzekutimi i një dënimi të mundshëm me burgim mund të jetë i vështirë dhe nuk mund të realizohet nëpërmjet procedurës së ekstradimit apo është refuzuar kërkesa për ekstradim.

Neni 68

Vendimi për të kërkuar transferimin

1. Vendimi për të kërkuar transferimin e procedimit penal merret nga organi i prokurorisë ose gjykata që procedon. Vendimi mund të ankimohej nga i pandehuri, mbrojtësi ose i dëmtuari në gjykatë brenda 10 ditëve nga marrja e tij. Në këtë rast, gjykata vendos për ankimin brenda 5 ditëve nga paraqitja e tij, mbi bazë dokumentesh.

2. Vendimi për të kërkuar transferimin në fazën e hetimeve paraprake nuk e pengon prokurorin që të marrë prova. Prokurori vendos zgjatjen e afatit të hetimeve, sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, në pritje të vendimit të shtetit të kërkuar. Ai ia njofton vendimin për zgjatjen e afatit hetimor Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

3. Nëse vendimi për të kërkuar transferimin merret gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata pezullon shqyrtimin gjyqësor dhe zbaton, për aq sa është e mundur, rregullat e nenit 343 të Kodit të Procedurës Penale. Pezullimi nuk pengon autoritetin gjyqësor vendas që të marrë prova që mund të çojnë në pafajësinë e të pandehurit dhe, kur vonesa paraqet rrezik, çdo provë tjetër të kërkuar nga palët.

Neni 69

Përcjellja e kërkesës

1. Prokurori i çështjes, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga data që vendimi i transferimit ka marrë formë të prerë, i përcjell Ministrisë së Drejtësisë vendimin gjyqësor të transferimit dhe fashikullin gjyqësor.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga marrja e akteve prej Prokurorit të Përgjithshëm, ia përcjell ato shtetit të kërkuar dhe i kërkon të njoftohet për pranimin ose jo të transferimit të procedimit penal.

3. Aktet përkthehen nga Ministria e Drejtësisë në gjuhën e shtetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranuar prej tij. Shpenzimet e përkthimit evidentohen dhe i përcillen organit të prokurorisë për t'u përfshirë në shpenzimet procedurale të parapaguara, sipas nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 70

Pasojat e pranimit ose të refuzimit nga shteti i kërkuar

1. Ministria e Drejtësisë i përcjell prokurorit të çështjes, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, njoftimin e shtetit të huaj për pranimin ose refuzimin e transferimit të procedimit penal.

2. Nëse shteti i kërkuar pranon transferimin e procedimit penal, autoriteti gjyqësor vendas që procedon vendos pushimin e procedimit penal për këtë shkak.

3. Nëse shteti i kërkuar refuzon transferimin e procedimit penal, ose nuk dërgon njoftim brenda gjashtë muajve nga marrja e kërkesës, autoriteti gjyqësor vendas vazhdon procedimin penal.

SEKSIONI II
TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE PENALE NGA SHTETET E HUAJA

Neni 71

Kushtet për pranimin e procedimit penal nga një shtet i huaj

1. Ministri i Drejtësisë mund të pranojë transferimin e procedimit penal në Shqipëri kur:
 - a) personi i dyshuar ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Shqipëri; dhe
 - b) nuk është i mundur ose i përshtatshëm procedimi i personit në shtetin kërkues për një ose më shumë nga shkaqet e mëposhtme:
 - i) personi i dyshuar është shtetas shqiptar ose shteti shqiptar është shteti i tij i origjinës;
 - ii) personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim me burgim në Shqipëri;
 - iii) autoritetet gjyqësore vendase kanë filluar procedimin penal për të njëjtën vepër penale ose për vepra të tjera penale kundër personit të dyshuar;
 - iv) çmohet se transferimi i procedimit penal i shërben zgjidhjes së drejtë e të përshtatshme të çështjes dhe procesit të rregullt ligjor;
 - v) ekzekutimi i dënimit penal të dhënë në Shqipëri mund t'i shërbejë një rehabilitimi më të mirë social të personit të dënuar;
 - vi) nuk mund të sigurohet thirrja dhe pjesëmarrja e personit të dyshuar në procedimin penal në shtetin kërkues;
 - vii) ekzekutimi i një dënimi të mundshëm me burgim në shtetin kërkues mund të jetë i vështirë dhe nuk mund të realizohet nëpërmjet procedurës së ekstradimit apo është refuzuar kërkesa për ekstradim.
2. Transferimi i procedimit penal nuk pranohet nëse ekziston ndonjë prej rrethanave që nuk lejon fillimin e procedimit penal të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm.

Neni 72

Veprimet e Ministrisë së Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë, nëse pranon kërkesën për transferim të procedimit penal, ia përcjell aktet brenda 30 ditëve prokurorit të rrethit të vendbanimit të personit të dyshuar, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, duke njoftuar njëkohësisht edhe shtetin kërkues.
2. Aktet përkthehen nga Ministria e Drejtësisë. Shpenzimet e përkthimit evidentohen dhe i përcillen organit të prokurorisë për t'u përfshirë në shpenzimet procedurale të parapaguara, sipas nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale. Në raste të ndërlikuara, për shkak të vëllimit të akteve për përkthim, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të zgjatet edhe 15 ditë.
3. Ministri i Drejtësisë, nëse ka konstatuar se kërkesës për transferim nuk i janë bashkëngjitur të gjitha aktet e nevojshme, por gjithsesi arrin në përfundimin që nuk është rasti për refuzimin e kërkesës për transferim, pranon transferimin e procedimit dhe ia përcjell aktet Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë rast, Ministria e Drejtësisë vepron, për aq sa është e mundur, sipas nenit 11 të këtij ligji. Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkues i përcillen organit të prokurorisë brenda 7 ditëve nga marrja e tyre, duke respektuar edhe detyrimin për përkthim.
4. Ministria e Drejtësisë vepron në të njëjtën mënyrë edhe në rast se i paraqitet kërkesë për plotësim aktesh nga autoritetet gjyqësore vendase.

Neni 73

Veprimet e prokurorit

1. Prokurori i rrethit gjyqësor ose ai i krimeve të rënda, me marrjen e kërkesës dhe akteve për transferim, regjistron procedimin penal dhe ndjek rregullat e Kodit të Procedurës Penale.
 2. Nëse prokurori vendos mosfillimin e procedimit penal, për shkak të rrethanave që nuk e lejojnë fillimin e procedimit penal, ai njofton brenda 5 ditëve Ministrinë e Drejtësisë, nëpërmjet
- 8100

Prokurorit të Përgjithshëm, duke i dërguar të gjitha aktet së bashku me vendimin e mosfillimit. Në këtë rast, Ministri i Drejtësisë ia kthen aktet shtetit kërkuar, së bashku me vendimin e mosfillimit të procedimit penal, brenda 20 ditëve nga marrja e akteve prej prokurorisë.

3. Prokurori që procedon, njofton Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm për çdo vendim që pezullon ose përfundon procedimin penal. Ministri i Drejtësisë ia përcjell menjëherë këto akte shtetit kërkuar.

4. Me kërkesë të autoritetit gjyqësor të huaj, Ministria e Drejtësisë i kërkon Prokurorit të Përgjithshëm çdo informacion të nevojshëm për ecurinë e procedimit penal në Shqipëri, si dhe vendimin gjyqësor përfundimtar.

Neni 74

Padia civile në procedimin penal të transferuar

Nëse aktet e përcjella nga shteti kërkuar, sipas këtij seksioni, përmbajnë edhe padinë civile, ajo shqyrtohet sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 75

Vlefshmëria e veprimeve të marrjes së provave

Mjetet e kërkimit të provave dhe provat e marra nga autoritetet gjyqësore të huaja janë të vlefshme në procedimin penal të pranuar në Shqipëri, përveçse kur ato bien ndesh me parimet themelore të rendit juridik shqiptar dhe parimet e akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 76

Aktet nënligjore

1. Mënyra dhe procedura e regjistrimit të dënimeve të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga autoritetet gjyqësore të huaja përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në nxjerrjen e këtij udhëzimi, Ministri i Drejtësisë bazohet në parimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të barazisë para ligjit.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të nenit 5 pika 3, nenit 48 pika 5, nenit 60 pika 4 bazohen në parimin e miradministrimit të fondeve dhe të procesit të rregullt ligjor.

Neni 77

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 45 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6363, datë 22.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 23.12.2009
 Doli nga shtypi më 24.12.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë